

## AKT THEMELIM DHE STATUT

I

### SHOQËRISË TREGTARE

“Smart Clima Solution” SHPK

Kreu i  
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “Smart Clima Solution” SH.P.K, (me poshtë e quajtur “Shoqëria”)

#### Neni 2

#### Themelimi

Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri.

#### Neni 3 Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 27/04/2022, në mbështetje të legjisacionit shqipëtar respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”,  
Une, themeluesi, kam krijuar, një shoqëri tregtare me emrin **“Smart Clima Solution” SH.P.K**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,

(2) Ortakët themelues të shoqërisë:

**-Z.Dorjan Çano**, i biri i Dashamirit, i datëlindjes 21.03.1980, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr “Muhamet Gjollesha”, Nd. 40, H. 1, AP. 34, Njesia administrative nr 7, Njesia bashkiake Nr 7, 1023, Tirane, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës e Kartës së Identitetit (ID) me numër personal I00321086T

#### Neni 4 Objekti

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Smart Clima Solution” SH.P.K** do të ketë objekt të veprimtarisë së saj si më poshtë vijon:

Në fushën e kondicionimit. Studim e projektim, prodhim, aspirim, montim i sistemeve qendrore, ngrohje ftohje, ngrohje me panele diellore, te ujët sanitar, ndertim dhe instalim i sistemeve te kondicionimit,... etj, duke u realizuar: Impante ajrim-Kondicionimit -Impante

## AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE

“Smart Clima Solution” SHPK

Faqë 1 nga 10

Hidraulike dhe hidrosanitare. -Impiante te antizjarrit, manual dhe automatik. -Impiante ftohje industriale. Dhoma frigoferike. Realizimi i supermarketeve, platformave industriale dhe qendrave te shperndarjeve. Montim i kaldajave, sobave, etj. EksportImport, tregti me shumice dhe pakice i te gjitha makinerive qe kane lidhje me kete objekt. Ne fushen e energjise, brenda dhe jashtë Shqiperise. Studim projektim, prodhim, ndertim dhe instalim i sistemeve te prodhimit elektrik nga burime te rinovalues. Menaxhim dhe aktivizim i projekteve financiare te aktiviteteve te siperpermendura. Sipermarje e ndertimeve per llogari e te treteve dhe konkretisht te ndertimit te hidrocentraleve dhe impianteve te prodhimit te energjise elektrike duke i ofruar klienteve te saj sherbinin e 2 plete qe nga fazat e para te projektimit, ndertimit deri ne kompletimin e ketyre strukturave me te gjitha pajisjet, makinerite dhe instalimet e nevojshme duke i dorezuar objektet ne gjendje funksionale. Sherbim mirembajtje parandaluese, riparuese dhe rinovaluese te objekteve te prodhimit te energjise si dhe te asistences studimore, teknike apo dhe te trajnimeve te personelit qe do te punesohet ne pajisjet dhe makinerite specifike te ketyre objekteve te prodhimit te energjise elektrike te cilat mund te jene Hidrocentrale, Centrale Eolike, Fotovoltaike etj sipas rastit te projektit. Pra edo gje qe ka lidhje me energjine elektrike. Ndermarrja e veprave qe kane lidhje me instalimet elektrike dhe mekanike, si dhe cdo lloj instalimi elektrik te rrymave te forta dhe te shitjen e metodologjive teknike, programeve, komponenteve, pajisjeve, sistemeve dhe impianteve ne sektoret: elektrik, elektronik, elektromekanik, informatike, termik, hidraulik, makineri, ndertime, energji, menaxhim teknologjik, komunikim, rregullim, automatizim, kontroll, telekontroll dhe telekomandim, supervizim. Projektim per llogari te vete si dhe per ti sherbyer aktivitetit te saj ne lidhje me te trete. Ndertim, riparim, shitje me shumice dhe pakice, shperndarje, perfaqesim aparaturash elektronike, elektromekanike, elektrike, pajisje dhe makineri telekomunikimi, komponent elektronik matjesh. Zhvillimin e studimeve, kerkimeve, matjeve, testimeve, perpunimin dhe raportimin e te dhenave dhe informacioneve te grumbulluara per llogari te vete ose te te treteve lidhur me sektorin e industrise, energjetikes etj. Organizimin e trajnimeve te ndryshme profesionale si per stafin e vet por dhe per te trete ne lidhje me industrine dhe aktivitetin e ndermarrjeve ne per gjithesi sipas lejeve dhe licencave te kerkuara sipas rasteve. Ne fushen e hidrokarbureve dhe mineraleve, brenda dhe jashtë Shqiperise. Konsulente teknike, ndermjetesimi tregtar, studim tregu, studime legjislacioni ne lidhje me industrine e naftes. Shpime per studime te nentokes dhe per hapje pusesh hidrologjike. Tregtim me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Eksport-import i karburanteve dhe nenprodukteve te tyre, hidrokarbureve ne per gjithesi. Perpunim dhe rafinim i naftes. Shitje te karburanteve te te gjitha llojeve, blerje, importim, eksportim, transportim, shperndarje me shumice te qymyrit, gazit, 3 lubrifikanteve, etj. Ndertimin dhe administrimin e impianteve, depozitave, etj. Blerje, importim, shitje e naftes dhe vajrave minerale te pa perpunuar, transportimin per llogari te vete dhe per llogari te te treteve, depozitim perzierjen, trajtimin, shitjen, shperndarjen me shumice te qymyrit, gazit, lubrifikanteve, produkteve te naftes dhe naftokimike, duke perfshire ketu edhe bitumet. Blerjen shitjen qiradhenien ndertimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndertesave dhe pasurive te veta te paluajtshme. Ne fushen e tregtise, brenda dhe jashte Shqiperise. Import-eksport e tregtim me shumice e pakice i mallrave te ndryshem industriale si pajisje elektronike e elektrike, materiale dhe lende ndertimi, inerte, makineri, pajisje, linja prodhimi te llojeve te ndryshme, automjete te tonazheve te ndryshem e pjese kembimi makinash dhe makinerish. Ne sherbim te aktiviteteve te mesiperme do te kryej dhe transportin e mallrave, makinerive, pajisjeve, personave etj. per llogari te vete apo te te treteve, me mijete transporti te vetat apo te te treteve.

---

#### AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE

“Smart Clima Solution” SHPK

Faqë 2 nga 10



**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë Tregtare “Smart Clima Solution” SH.P.K është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

**Neni 6**  
**Selia**

(1) Selia e Shoqërisë Tregtare “Smart Clima Solution” SH.P.K është në Tiranë, në adresën: Tiranë, Kashar, Rruga Pavarësia-pas ndërtesës “Casa Italia”, pallati i ri, ambient me nr DO1, kati përdhe, Komuna -Kashar-Tiranë. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime te komunikimit elektronik është si vijon:  
dorian80cano@gmail.com

**Kreu II Kapitali**

**Neni 7**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestari i Shoqërisë Tregtare “Smart Clima Solution” SH.P.K është 100,000 (njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin ë shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues: **Dorjan Cano** zotëruesh i 1 (një) kuotë më vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqindmijë) Lekë që përbën 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kontributet e mësipërme janë shlyer tërësisht.

**Neni 8**  
**Zmadhimi dhë zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjësëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohën për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 9**

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

“Smart Clima Solution” SHPK

Faqa 3 nga 10



### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshmë ndërmjët ortakëvë, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 10**

##### **Organë Vendim-marrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vëndimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjëjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjetë mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhë "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamplenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të vëprojë si përfaqësues i ortakëve në asamplenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

---

#### **AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

#### **"Smart Clima Solution" SHPK**



**Neni 11**  
**Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vëndin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë së 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**Neni 12**  
**Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë së 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhë Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë së 30 ditë, me të njëtin rend dite.

**Neni 13**  
**Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin osë zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
  - ë) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Neni 14**

---

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

**“Smart Clima Solution” SHPK**



## Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushتروجë të drejtë e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësuës i autorizuar, i autorizuari vlërësohet të jetë në të njëjtin konflikt intérssi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 15 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshmë emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Afat i emërimit, është 2(dy) vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

**Me themelimin e shoqërisë emërohet Administrator Z.Dorjan Çano, i biri i Dashamirit, i datëlindjes 21.03.1980, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr “Muhamet Gjollesha”, Nd.40,H.1,AP.34,Njësia administrative nr,7,Njësia bashkiake Nr 7,1023,Tiranë shtetas shqiptar , madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës e Kartës së Identitetit (ID) me numër personal I00321086T , që do të qëndrojë në detyre për një afat 2 (dy) vjecar me të drejtë rizgjedhje.**

## Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhë nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpëra asamblesë së përgjithshme për miratim;

---

## AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE

“Smart Clima Solution” SHPK

Faqë 6 nga 10



- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë rregjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohët në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikavë tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratri eshtë i detyruar të thërresë Asamblenë e Përgjithëshmë, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetmë financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivët e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rëzulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brënda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 16** **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori eshtë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa eshtë parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 ë 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori/ët detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjën e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë më përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ato të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij më profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme më qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi eshtë kryer në mirëbesim.

---

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

**"Smart Clima Solution" SHPK**



3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Trëgtarët dhë Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet ë mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivët shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet përsonalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen ë plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV Viti finanziar-ekspertët**

##### **Neni 17 Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 18 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëvë për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

---

#### **AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

**"Smart Clima Solution" SHPK**



**Kreu V**  
**Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 19**  
**Prishja dhë likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhë emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 20**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni 21**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhë dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 22**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhë të tretëve, në rast se ato nuk zgjidhen me mirëkuptim mes palëve, për zgjidhjen e tyre do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

---

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

**“Smart Clima Solution” SHPK**

Faqa 9 nga 10



**ORTAK I VETËM**

**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Smart Clima Solution” SH.P.K**

**DORJAN ÇANO**

*Dorjan Cano*  
*DC*

---

**AKT THEMELIM DHE STATUT I SHOQËRISË TREGTARE**

**“Smart Clima Solution” SHPK**

Faqë 10 nga 10

*DC*